



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 06/08
Prishtinë, me 22 4. 2008, në orën 13,30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 301

P R O C E S V E R B A L

**i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović,
Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira
Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati - anëtarë.

Lejla Selimi nga OSBE, Elita Vokshi

Kryetari e hapi mbledhjen dhe Komisionit ia propozoi këtë

REND DITE

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
- 2 Miratimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2008
- 3 Shqyrtimi i disa peticioneve
- 4 Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua.

U hap diskutimi për pikën e parë.

1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Pasi nuk pati vërejtje u miratua.

2 Miratimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2008

Ismet Beqiri - I njoftoi të pranishmit lidhur me përgatitjen e planit të punës së Komisionit për vitin 2008. Kërkoj prej tyre ta miratojnë planin e punës në parim, ndërsa miratimi përfundimtar të behet në mbledhjen ardhshme. Anëtarët u pajtuan me propozimin e tij dhe u hap debati.

Ibrahim Makolli - I përshëndeti të pranishmit dhe shtoi: Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës e ka autorizuar Komisionin për Legjislacion për formimin e panelit intervistues për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, por kjo procedurë do t'i takonte Komisionit për Drejtat e Njeriut. Mirëpo deri më tani nuk është formuar ky Komision. Duke folur lidhur me strategjinë e të drejtave të njeriut theksoi se ajo përfshin rininë, pakicat kombëtare, personat me aftësi të kufizuara etj. Për këtë kërkohet bashkëpunim me institucionet dhe me Avokatin e Popullit, që do t'i raportojë Komisionit lidhur me monitorimin e ligjeve dhe për financat etj. Ai u pajtua që në të ardhmen të vizitohen shtëpia e pleqve, shkollat, Zyra për Qeverisje të Mirë, zyrat për të drejtat e njeriut dhe njëherit u kërkua të monitorohen Ligji për shëndetësi, Ligji për grevat, Ligji për konsumatorët dhe të përfshihen në planin e punës.

Nerxhivane Dauti – U pajtua me parafolësin. Lidhur me formimin e panelit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit shtoi: Në panelin intervistues për zgjedhjen e Avokatit të Popullit isha anëtare në të dy legjislaturat e mëparshme, por tani janë krijuar kushtet që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione ta formojë panelin. Ishte e mendimit se kjo çështje duhej të shtrohej në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke bërë me dije se jemi më kompetentë sesa Komisioni Legjislativ. Ajo me këtë rast tha se nuk donte ta nënçmonte askë, por kompetencat profesionale dhe operacionale, jo pse ne dëshirojmë, por rendi juridik e kërkon të respektohen.

Sa i përket planit të punës të Komisionit e vlerësoi lart dhe i falënderoi kryetarin dhe stafin mbështetës të Komisionit për punën e bërë. Shtoi se vazhdimisht plani do të plotësohet në bazë të nevojës. Në këtë kontekst kërkoi që në plan të përfshihen vizitat në ato shtete në të cilat ka komisione homologe dhe demokraci të zhvilluar, si p.sh.: Shqipëria, Kroacia, BH dhe Sllovenia, kurse lidhur me peticionet propozoi të vizitohet Skocia ose Spanja, meqë e kanë një përvojë në këto fusha.

Naim Rrushemi – U pajtua me diskutimin e parafolësit dhe nënvizoi: Formimi i panelit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit i takon Komisionit për të Drejtat e Njeriut, prandaj kërkoi nga kryetari që të jetë me këmbëngulës në mbrojtjen e përgjegjësi të Komisionit. Në fund u pajtua që të gjithë anëtarëve t'u ofrohen peticionet për të pasur qasje dhe si Komision të marrim vendime lidhur me to.

Shpresa Murati - Duke u ndërlidhur me shkresën dërguar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, i informoi të pranishmit për përmbajtjen e saj.

Ibrahim Makolli – Propozoi që sërish t'i drejtohem Kryesisë së Kuvendit, që ajo ta autorizojë Komisionin për të Drejtat e Njeriut, për formimin e panelit dhe njëherit propozoi që Komisioni të takohet me kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për se afërmi ta informojë për rrjedhën e kërkesës. Me propozimin e tij u pajtua Komisioni.

Sanije Alijaj – Duke u ndërlidhur me parafolësen, u pajtua me planin e punës. Sa i përket formimit të panelit do të ishte mirë që gjysma e anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të marrë pjesë në të, ngase ka ekspertë të mjaftueshëm. Në fund i kërkoi Komisionit që ta ngritë çështjen e amendamentimit të Rregullores së punës së Kuvendit, me qëllim që të përfshihet fushëveprimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione.

Hajredin Hyseni – Nënvizoi: Formimi i panelit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit i takon këtij Komisioni dhe sërish do të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që ta shqyrtojë. Nëse nuk do të ketë sukses, këtë çështje do ta ngremë në seancën plenare. Në fund kërkoi nga Komisioni që për çdo muaj ta bëjmë nga një vizitë në terren.

Luljeta Shehu - Propozoi të vizitohen Krusha e Madhe dhe ajo e Vogla, që kanë kërkuar një takim të përbashkët me anëtarët e Komisionit.

Vezira Emrush - Lidhur me planin pati vërejtje, se pse nuk iu ka ofruar në gjuhën amtare buleteni i zyrës për barazi gjinore. Ajo i çmoi vizitat në terren dhe u angazhua për një platformë më të mirë.

Drita Maliqi – Lidhur me planin e punës vuri në pah: Ka vend të plotësohet dhe kërkoi specifikim konkret të gjërave. Pra, ajo e mbështeti në parim propozimplanin e punës duke shtuar se në mbledhjen e radhës ai do të miratohet.

Në begatimin e planit të punës kontribuoi edhe deputetja Radmila Vujovic.

Ishte konstatim i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit se plani i ofruar i punës ka bazë. Lidhur me këtë u nxor ky

P e r f u n d i m

Komisioni e miratoi në parim planin e punës për vitin 2008 dhe vendosi që ai të miratohet në mbledhjen e radhës.

3 Shqyrtimi i disa peticioneve

Nerxhivane Dauti – Tha se vetëm pesë peticione kanë ofruar zgjidhje. Ajo kërkoi nga Komisioni që petitionet e mbetura t'u shpërndahen anëtarëve, pasi vlerësoi se përmbajtja e tyre tregon se janë raste të rënda. Gjithashtu kërkoi të vazhdohet edhe me to si me praktikatat e dy legjislativave të mëparshme, që kanë dhënë rezultate të mira, për zgjidhjen e kërkesave të peticioneve nëpërmjet dëgjimit publik. Me këtë i propozoi Komisionit të ftohen nënshkruesit e petitionit të Sindikatës së Pavarur të Auto Shtëpisë “Kompresor” nga Gjakova që janë të larguar nga puna nga AKM-ja për dëgjim publik dhe të na informojnë pse janë të larguar nga puna. Njëkohësisht u kërkua që në këtë dëgjim të ftohet edhe përfaqësuesi i AKM-së. I njoftoi anëtarët për përmbajtjen e peticioneve të shqyrtuara të: Bajram Bajgorës, Zeqir Shalës, Hasan Kastratit dhe të Zeqir Osmanit.

Kryetari e falënderoi Nerxhivane Dautin për punën e bërë dhe lidhur me këtë nxori këtë

P ë r f u n d i m

U vendos që më 6. 05. 2008, në orën 13,30, Komisioni të mbajë dëgjim publik për 25 nënshkruesit e petitionit nga Gjakova që AKM-ja i ka larguar nga puna.

4 Të ndryshme

Kryetari e përshëndeti OSB-në që ka ofruar mbështetje legislative për zhvillimin e politikave, për amendamentimin e Ligjit për barazi gjinore si dhe për Projektligjin për personat e pagjetur.

Ibrahim Makolli – Kërkoi në vazhden e takimeve të vizitohet shkolla e mesme “Naim Frashri“. Kjo vizitë të bëhet me ndërmjetësimin e znj. Igbale Potera.

Naim Rrustemi - Nuk u pajtua me propozimin e parafolësit dhe kërkoi t’u shmangemi fushatave zgjedhore.

Ishte konstatim i përgjithshëm që të nxirreshin këto

P Ë R F U N D I M E

- 1. Komisioni të kërkojë që Kryesia e Kuvendit të përshpejtojë hartimin e Rregullores së punës së Kuvendit në të cilën do të përfshihet Komisioni për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinor, Personat e Pagjetur dhe Peticione.*
- 2. Komisioni kërkon nga Zyra e Kryeministrit përshpejtimin e procedimit në Kuvend të Projektligjit për personat e pagjetur.*
- 3. Komisioni kërkon takim me kryetarin e Kuvendit të Kosovës me qëllim që për së afërmi të informohet lidhur me punën e formimit të paneleve.*

Mbledhja përfundoi në orën 15,30.

Procesverbalin e hartoi

Rrahim Demaj, zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri
